

Oral History Kosovo

INTERVISTË ME MULLA XHEVAT KRYEZIU

Prishtinë | Data: 26 janar, 2016

Kohëzgjatja: 90 minuta

Të pranishëm:

1. Mulla Xhevat Kryeziu (I intervistuari)
2. Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
3. Jeta Rexha (Intervistuesja)
4. Noar Sahiti (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i/e intervistuari/a shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje

Pjesa e Parë

Jeta Rexha: Zoti Xhevat a mundeni me n'a folë pak për fëmininë e jujë, rrethin ku jeni rritë, familja e jujë qysh ka qenë, ju qysh keni qenë si fëmi edhe gjanat që i mbani n'mend si fëmi?

Mulla Xhevat Kryeziu: Po si fëmi, si çdo fëmi i kosovarit, jemi rritë në kushte të randa ekonomike. Rrjedh nga një familje, kështu me tradita t'vlerave, me tradita kombëtare, njerëzore, morale, fetare e t'gjitha këto me rradhë. Dhe si fëmi, kohën e kemi kalu shumë të vështirë. Kushtet tona kanë qenë jashtëzakonisht t'vështira. Kemi udhëtu dikun gjashtë-shtatë kilometra me shku n'shkollë. Pastaj s'kemi pasë libra, s'kemi pasë veshmbathje, s'kemi pasë ushqime t'mira, derisa kem fillu pak që me u rritë, kem fillu... se babën t'pashkollumë, nanën t'pashkollume, familja e pashkollume edhe e papunësime. Domethanë kushtet tejet t'rana t'asaj kohe, qe une e përjetoj edhe e maj n'mend.

Kështu që t'u e pa nevojën e arsimimit, e shkollimit, e t'angazhimit, jemi detyru nashta edhe jashtë atyne mundësive tona, kapaciteteve tona, për me u gjetë, për me ardhë deri tek rritja, shkollimi, te punësimi, edhe me e mbajtë familjen. Prandaj, kemi pasë kushte t'vështira, kushte t'randa dhe jo vetëm une, po e mbaj n'mend i tërë fshati, e tërë gjenerata ime, shoktë e mi. Une kom shku n'shkollë, une e maj n'mend, kom shku n'shkollë me opangë t'likurës. Unë e maj n'mend, n'vend t'çantës kom bajtë, si me thanë, çantë ose *jangjik*¹ të lëkurës, t'marume, qe ma ka maru nana.

Erëmirë Krasniqi: N'cilin vit keni lind?

Mulla Xhevat Kryeziu: Unë jam lind me 19 t'katërtin, 1958-n. Edhe kështu që kam çka tham, kam çka rrëfej për fëmininë time, se kemi vujtë, kemi hjekë. Pastaj pushteti i hujë, familja ime kishte vujtë. Gjyshi im...

Jeta Rexha: Cili ka qenë fshati i jujë?

Mulla Xhevat Kryeziu: Fshati Bubavec, kuvendi komunal tash i Malishevës. Gjyshi im për politikë ishte dërgu n'burg. Dënohet me katër vjet n'burgje t'Nishit. Atje e mysin nga torturat edhe sot e asaj dite nuk ia dimë as varrin. As s'kemi pasë mundësi me hapë t'pame për të. Domethanë, pastaj familja asht' leçitë, asht' largu, s'kanë guxu njerzit me ardhë. Shteti na ka marrë n'sy, edhe kështu qi kemi pasë

¹ Shqipe e vjetër: çantë, strajcë e vogël.

kushte t'randa t'ekzistimit edhe t'jetesës. Prandaj ajo ishte ni situatë edhe ni kohë shumë e vështirë, e randë e asaj kohe. Dhe shpesh herë ndoshta, edhe kur iu tregoj fëmive t'mi se qysh kemi vujtë, "A thu babë si asht' e mundun?" Asht' e mundun se kanë qenë rrethanat e tilla, që kemi përjetu tmerr, kemi përjetu gjithçka.

Jeta Rexha: A mundeni me na tregu edhe për gjyshin, çka ka qenë aktiviteti i tij?

Mulla Xhevat Kryeziu: Gjyshi im ka qenë kryeplak i fashtit. Atëhere lëvizjet e kaçakëve, i ka strehu ata njerëz që i kanë ba rezistencë kauzës kombëtare, qe nuk janë pajtu me regjimin e Jugosllavisë t'asaj kohe, edhe pse ne i kemi përkrah ata, edhe pse ky si kryeplak i fshatit dhe i ka strehu ata njerëz. Edhe ata njerëz janë zanë n'familjen time, janë pushkatu ata pa gjyq, Mustafë Dërguti me djalin Nuredinin edhe ni nip qe emrin po ia harroj. Tre vetë janë pushkatu. Babëgjyshi im edhe tre kusheri tjerë janë marrë e janë dërgu në burgun e Prizrenit. Janë gjyku n'Prishtinë, edhe janë vujtë, i kanë çu, i kanë internu në burgjet famëkeqe të Nishit. Dhe gjyshin tim në Pozharevc edhe në Nish, kështu që gjyshin tim e nxen vdekja në burgun e Nishit. Edhe nuk e dimë sot e asaj dite ku e ka varrin. Domethanë, pi maltretimeve, pi torturave, pi rrahjeve, kanë ardhë deri te likuidimi fizik i tina.

Edhe aq ma e keqe, kur ka vdekë, kanë lajmëru njerëzit, "Ka vdekë Limon Azizi" edhe nuk kemi guxu me majtë t'pame, se kemi qenë të përjashtumë nga shteti. Nuk kanë guxu miqtë, natën kanë ardhë me na pa. Domethanë nuk kemi guxu me hapë t'pame si zakon për familjen tonë. S'kemi guxu! Kjo ka qenë ajo qe asht' e dhimbshme, qe asht' e tmerrshme, mos me guxu edhe t'pame me majtë, mos me guxu me manifestu mërzinë para tjerëve, pse po mërzitesh se shteti e ka ba këtë punë. Ky ishte shteti serbo-sllav.

Erëmirë Krasniqi: Sa fëmi keni qenë?

Mulla Xhevat Kryeziu: Na keni qenë, kemi lind gjithsejt gjashtë vëllazën e dy motra. Ni motër ka vdekë, ndërsa na jemi gjashtë, shtatë. Gjashtë vëllazën edhe ni motër e kemi.

Jeta Rexha: Qysh ka qenë jeta e jujë si fëmi atëhere? N'cilën shkollë keni shku?

Mulla Xhevat Kryeziu: Na kemi shku në shkollën fillore "Adem Bajrami" t'Kievës. Atje e kemi kry shkollën fillore unë edhe tanë vëllaznit e mi edhe motra ime. Edhe më pastaj, tani unë kam vazhduar në medresenë e mesme "Alaudin" këtu në Prishtinë, kam mbaru pesë vite. Dhe më pastaj e kam kry Shkollën e Lartë Pedagogjike, histori-gjeografi n'Gjakovë, n'Bajram Curr. Dhe punoj që nga viti '79 deri sot, punoj si punëtor, ose islamolog në xhaminë e fshatit Bubavec. Njikohësisht qe katër mandate jam edhe kryetar i Bashkësisë Islame të Malishevës.

Jeta Rexha: Po n'Gjakovë kur keni shku?

Mulla Xhevat Kryeziu: Po masi e mbarova une medresenë këtu, une e kisha dëshirë me u regjistru në Fakultetin Filozofik, dega e Orientalistikës. Por atëherë Sarajeva e kishte hapë Fakultetin e Studimeve Islame dhe don që kuadrat e medresesë t'shkojnë n'fakultet në Sarajevë, e mos me pasë t'drejtë me u regjistru n'shkolla tjera, ni marrëveshje me Ministrinë e Arsimit. Kjo ka qenë ni marrëveshje famëkeqe

për ne. Pra nuk ke pasë t'dejtë ku t'dush ti m'u shkollu. Se me medrese ke pasë t'drejtë në t'gjitha fakultetet, vetëm a je i zoti me t'pranu. Se ka qenë ni shkollë që ka pasë kuadra, ka pasë gjenerata, dhe kanë korrë sukses në çdo shkollë që kanë shku n'xanësit e medresesë.

Edhe kështu që ne jemi detyru, atëherë s'kemi mujtë me u regjistru në Fakultetin e Orientalistikës, atëhere ishëm kallabllak fëmi, ishëm... i kishëm pleqtë, i kishëm gjyshin, e kisha vëllavin e gjyshit, ashtu që u detyrova me u marrë me punën, me iu ikë studimeve për pak kohë dhe me iu siguru ekzistencë. Gradualisht, kadal ma vonë, tani viteve t'90-ta, unë e regjistrova, n'fund n'shköllën e naltë u regjistrova edhe atje mbarova studimet. Edhe nuk e ndërpreva punën, e kam vazhdu. Kështu që jam i kualifikum edhe n'aspektin e historisë-gjeografisë dhe edhe n'aspektin e këtij profesionit tim që e kam fillu mas klasës së tetë, domethanë medresesë.

Masi unë e krewa klasën e tetë, kisha pasion, kisha dëshirë të merrem [me fe], pasi prindërit e mi kanë qenë fetarë, janë marrë me fenë. Gjithmonë na kanë eduku n'atë frymën e edukimit njerëzor, shpirtëror, moral, kombëtar. Edhe unë kështu fillova t'mendoj ku t'gjindem pas klasës së tetë, si n'xanës ose si semimaturant atëhere. Kush andërrat e tija ka m'u regjistru, ku me shku, kah kishin njerëzit që kishin sens, ku ia merrje menja që korr sukses. Edhe unë e gjeta veten, unë thashë, "Unë du me u regjistru në medrese". E baj bisedë me babën, thotë, "Ku t'dush, unë s'po t'pengoj, ku është dëshira e jote". Edhe çka ndodhi këtu? Dhe unë erdha dhe u regjistrova në medrese.

Edhe kur u regjistrova në medrese, m'pranunë, "S'ka problem" edhe gjatë kësaj kohe, vitet e '70-ta, '71-72, aty ato vite, dhe vjen dikush nga afërsia ime, që nuk e di sot e asaj dite [kush ka qenë], dhe vjen e tërheqë dokumentacionin, ma tërheqë n'medrese. Nuk don me m'lanë mu në këtë rrugë, kinse asht' prapambetuni, kinse na duhet me ecë përpara, kinse na ke kthy mbrapa. Edhe nuk e di kush vjen edhe m'i tërheqë dokumentat.

Edhe kur vij unë këtu, fillon procesi mësimor, vij n'shtator, edhe m'thojnë, "Ti djalë çka po do këtu?" "Po jam pranë n'shköllë more. Pse, qysh çka po du? M'keni pranë." Thotë, "Jo, ti s'i ki dokumentat këtu." "S'është e vërtetë." "E vërtetë, s'o e vërtetë, kqyr o zotni, o ti djalë," m'thotë ai drejtori, "këtu dokumentat e tu i ka marrë dikush." "Po kush more i ka marrë dokumentat e mi?" "Ka ardhë ni familjar i yti, i ka marrë." "Po mirë more zotni, po a duhet me nënshkru unë, unë me qenë, a dikush. A e din kush i ka marrë?" "Jo, nuk e di, veç dikush i ka tërheqë." Dhe çka ndodhi? Jam detyru, jam kthy, jam ardhë m'u regjistru masi e kom hupë vitin, në gjimnazin e Kievës. U hapte gjimnazi atëhere edhe jam regjistru. Po gjithmonë mendjen te medreseja, gjithmonë mendjen këtu.

Dhe unë nuk du me mësu atëherë, nuk doja t'mësoja. Edhe e kisha ni profesor, ma tash i ndjerë, i cili ka qenë ni njohës i mirë i gramatikës t'gjuhës shqipe, mos t'tham ndoshta i pari n'Kosovë edhe do t'thotë që o i pari. Ka qenë ni Tafil Kelmendi, ka qenë ligjërues i studimeve këtu, i albanologjisë. Ka vdekë n'Vushtri. Dhe Tafili vjen edhe m'regjistron në gjimnazin e Kijevës, tuj aludu se asht' mbrapametuni, s'asht' e kohës, s'asht' përparimtare, s'janë ide këto dhe unë u nala aty. Dhe për fat edhe Tafilin kujdestar klase. Dhe unë nuk doja t'mësoja edhe fare. Dhe isha i dobtë, se s'dojsha me mësu. Edhe Tafili thotë... i kisha unë dikun gjashtë-shtatë nisha, po edhe nuk dojsha me mësu, thotë, "Xhevat

Kryeziu, i ka pasë dy t'dobëta, po këshillit të arsimtarëve iu luta edhe pak e kam ni lidhje afërsie, edhe kështu Xhevat Kryeziu kalon, edhe kalon Xhevati.” Thashë, “Jo, jo, une s’kom kalu. S’du me kalu.” “Po, o djalë, a je normal?” “Jam normal profesor, une nuk du me u ndalë, unë nuk du me u nalë n’gjimnaz”. Edhe posa u mbaru viti i kom marrë dokumentacionet, prapë jam ardhë n’medrese, me dokumenta.

Jeta Rexha: Cili vit ka qenë ky?

Mulla Xhevat Kryeziu: Viti ’73-74. Edhe vij n’medrese, i tham drejtorit, “Une jam Xhevat Kryeziu, kam apliku vjet, kam konkuru. M’i kanë marrë dokumentacionet, kam qenë n’gjimnaz, s’kom kalu, s’kom dashtë me nejtë. Jam i përqendrumë n’medrese.” “Hajde bre djalë se s’ka problem.” Edhe jam vendosë edhe kam vazhdu, edhe e kam kry me sukses t’mirë medresenë.

Dhe filloi procesi mësimor, dita e parë. Vij une në medrese dhe m’bjen rradha me u ulë n’bankën e fundit, afër ni dritareje. Dritarja çelë, dritare e hekurit. Edhe m’prezandon profesor Mulla Sadriu, “Si quheni ju?” Une çona n’kamë, “Xhevat Kryeziu” edhe t’ia hi me kokë dritares. Tha, “Une Kryeziu p’e di, po...” thashë, “Qe de, Xhevat Kryeziu.” Edhe t’i jap une me kokë dritares. Nuk e harroj, domethanë qe po flas qe 40 vite. Edhe ai i ndjeri, rahmet pastë, mëshirë pastë qe thojmë na, gjithmonë tani thojke, “Hajt Kryezi, hajt ti Kryezi...” dhe ishte kjo ajo dita e parë e medresesë që nuk e harroj kur i rashë me kokë dritares. “Xhevat Kryeziu,” tha, “p’e di qe Kryezi, po...” demek qe ia hina dritares, Xhevat Kryeziu, qyshtu.

Edhe në medrese, për mu ishte, prapë një kohë ishte e vështirë. Gjendja ekonomike ishte e randë për mu, prapë ishte e randë. Por falenderoj krijuesin e gjithësisë edhe gjithë ata donatorë që kanë ndihmu medresenë. Dhe aty kemi pasë 50 me 50, 50 përqind me pagu vetë, 50 përqind ke pasë me pagu, qe ka qenë ushqimi, ka qenë edhe internati. Domethanë, pak ni mundësi, ni 50 përqind, ni mundësi qe për mu ishte boll, ishte mjaft. Se ndoshta mos me pasë qenë edhe ai 50 përqind, nashta s’kisha mujtë edhe aty me vazhdu mësimin.

Jom nisë me ardhë n’Prishtinë, sikur tash me thanë, kushton prej Kievës me ardhë n’Prishtinë, dy evro e gjysë t’i merr autobusi. Jom ardhë me dy evro e gjysë për me nejtë ni javë edhe aty kom hargju dy evro e gjysë, ia kom dhanë kondukterit edhe kom qenë ni javë ditë n’Prishtinë pa asni cent. Edhe ia kam marrë ni shokut edhe dy evro e gjysë me u kthy, me shpresë se n’javën tjetër ndoshta do t’sjellë ndonjë lekë tjetër edhe me ia dhanë atij shokut. Edhe kështu qi m’kanë nimu edhe shoktë shumë. Domethanë, kjo ka qenë ni gjendje e randë, n’përgjithësi te disa familje. Ne na patë shkelë qashtu koha e historisë. Na patë shkelë, na patë injoru, na patë gjunjëzu. Jo me t’lanë m’u shkollu, jo me t’lanë m’u punësu, jo me t’lanë me përparu edhe ishte krizë. Familja ime ka mbetë gjallë me bujqësinë, me blegtorinë. Edhe kështu qe ishte situatë e randë.

Prandej kam mjaft, kam mjaft kujtime t’asaj se qysh jam ardhë e qysh jam kthy, qysh kom jetu ni javë ditë, qysh kom nejtë. Une e shoh sot, fëmitemë e mi i marrin katër-50 euro, pesë-60 euro, s’kënaqen, s’pajtohen. E kanë garderobën e mirë, e kanë ushqimin e mirë, kanë telefona, kanë standarde, regjistrojnë autoshkollat edhe prapë s’janë t’kënaqur. S’jam une i kënaqur me mësimin e tyre, “Babë, qe valla rava n’këtë provim, babë...” “Pse babë bre, tana kushtet, me rrymë...” Vjen, fëmitemë e mi dal i

marr n’Kievë me makinë. I çoj dej n’Kievë n’autobus me makinë. Mu, kush? Unë jam çu n’orën pesë, kom kalu nëpër 50 qenë me shku dej n’Kievë. Nëpër 50 qenë, nëpër 50 sakrifica, nëpër 50 rreziqe. Fëmi, 16 vjeç. Natën mu çu n’ora pesë, me dalë me e zanë autobusin e shtatë e gjysëve, me ardhë n’Kievë. Ishte tmerr! Borë, mraz, ftoftë. N’mëshirën e zotit, pa t’përcjellë askush, fare absolutisht.

Edhe kjo një gjendje e randë. Prandaj ndryshimi i asaj kohe me këtë kohë, jemi larg, shumë larg, shumë larg, shumë larg. Prandaj, gjenerata e re nuk p’e jep maksimumin e vet t’mundësive, për me u shkollu, me ia ditë vlerën arsimit, shkollës e diturisë. Se dituria asht’ gjeneratori i t’mirave që i sjellë n’këtë botë zoti. Dhe une pastaj e mbarova medresen, diplomova. Disa nga shoktë e mi dolën në Lindje, në botën e Lindjes, n’shtete arabe. Ni pjesë dulën atje, i kryjnë studimet. Une meta mbrapa tyre për shkaqe ekonomike dhe m’i nimu familjes. U punësova menjëherë, domethanë si e kam kry shkollën, si kam diplomu une jam punësu në detyrën e imamit. Edhe këto ishin rastet që une i kam përjetu, edhe une me shumë shokë, edhe me familje, edhe me shumë familjarë, edhe me shumë bashkëkombas t’mi. Po situata ishte e tillë që me i përballu ato sfida t’jetës. Tash osht’ diçka krejt tjetër.

Jeta Rexha: Ëhë. Çka ka qenë aktiviteti i jujë gjatë viteve e t’80-ta?

Mulla Xhevat Kryeziu: Gjatë viteve t’80-ta, une fillova karrierën time si i ri në një profesion shumë t’ndjeshëm. Ku unë këto vite i kom bo, nuk e di çka osht’ me veshë pantollë farmerkë, as me math patike, as me dalë me lu me top, as me u marr me naj aktivitet sportiv. Ishte mentaliteti i asaj kohe, “Hoxha qysh me lu me top? Hoxha qysh me veshë trenerka? Hoxha qysh me i lëshu floktë? Hoxha qysh me pasë syza? Hoxha qysh me hyp n’kerr, me i grah kerrit? Turp!” Une kam zatetë n’kohë. Qe 37 vjet që jam dalë n’detyrë, që 37 vite, goxha asht’ ni kohë e gjatë. I kom zanë... domethanë i takoj qasaj gjenerate që kom taku njerëz se janë le n’viti 1880 a ’90. 1800 domethonë, tash 2000, domethanë i kom taku njerëz t’shekullit 18, 19, edhe tash jem n’shekullin 20. Domethanë dikun 58 vite.

Edhe kështu që këto ishin ato peripetitë, ato... edhe ajo nostalgjia, edhe ato vujtjet, edhe ato saktificat. Kanihere naj moment i kënaqshëm, por shumë pak, dhe ma shumë t’hidhrueshme. Gjithmonë tu u përpykë: çka me ba, çka me mbërri. Edhe profesoni im ishte i tillë, thashë. Ishte ni profesion që duhet me pasë kujdes n’sjellje, n’biseda. Ishte një mision hyjnor, i shenjtë, predikues, i fjalës t’zotit. Duna me qenë vetë shembull i moralit e etikës, për me i dhanë dikujt tjetër shembull une. Thashë, nuk kom guxu, ato sene nuk kom guxu m’i bo. S’kom guxu m’i bo, absolutisht. Me m’pa kush tu lujtë me top, fare. Me m’pa kush tu lujtë shah, me m’pa dikush tu lujte me letra, ka qenë turp. Dhe kështu jam rritë, kështu jam eduku, kështu gati edhe u pjeka. Gjithmonë, “Kuku, marre! Po koritna! Turp!” edhe për me i dhanë dikujna diçka, me e arsimit, me ndihmu. Edhe kështu që deri në vitet e ’90-ta ka qenë domethanë angazhimi im n’aspektin e profesionit tim, t’edukimit t’njerëzve, të përmisimit t’karakterit t’tyne, t’moralit, t’afërsisë me ta, si t’i edukoj, si t’shkollohen, si t’rriten, si t’jenë njerëz, si t’a dojnë shkollën, si t’a dojnë atdheun, si t’i dojnë prindtë, si t’a dojnë mësusin. Edhe këto kanë qenë ato pikat që une i kom sygjeru, edhe kom mësu gjenerata e gjenerata.

Edhe pastaj, pasi që edhe fillimi, ngjarjet e ‘81-shit, ishin ato ngjarje që... ju si keni përjetu, shyqyr që si keni mbërri ato. Se filloj me u lëkundë bota shqiptare, m’u lëkundë koncepti i çashtjes kombëtare

n'përgjithësi. Çka osht' shqiptare filloi me u rrënu, te studentët, burgosja e intelektualëve, burgosja masive e njerëzve, dëbimi masiv i gjeneratave jashtë. T'bojke presion, t'rrafke dru, atje s'ta jepke pashaportin. Pi shumë presionit, me intervenu, me dhanë para shumë, me ta dhanë pashaportën, me ikë jashtë. Ishin këto sene t'rana.

Dhe tu e pa situatën, tu jetu me to, tu e pa gjithmonë kërkesën e popullit, vullnetin e popullit për ndryshim t'ni gjendje t'tillë, se nuk durohej kështu. Burgoset elita intelektuale: profesorë, intelektualë, njerëz atdhetarë, njerëz qe e dojnë, njerëz qe don me e pa... nuk kishum na, s'kishum pretendime territoriale me shku me marr territor n'Serbi na. Na veç dojshim t'mësojmë shqip, t'punojmë shqip, t'desim shqip. Kjo ishte ajo dëshira e jonë. Edhe këta na e murr atëhere regjimi i asaj kohe. Nuk na lente, "Ju shqiptarët s'duhet m'u shkollu. Ju shqiptarët s'duhet mësu. Ju shqiptarët mirë e keni. Ju duhet me qenë shtresa ma e ultë e botës, me qenë shërbëtorë t'Serbisë". Edhe ata me bo çfarëdo me neve.

Jeta Rexha: Po iu kuptoj. E ju ku keni qenë në '80-81?

Mulla Xhevat Kryeziu: Në '81? Po tash unë kam jetu bashkë me kohën. I kam përkrahë protestat e studentëve, i kam përkra lëvi...

Jeta Rexha: Si ligjerues apo...

Mulla Xhevat Kryeziu: Jo, une dola, vitet '79 kom dalë n'detyrë.

Jeta Rexha: OK. Çka ka qenë detyra e jote?

Mulla Xhevat Kryeziu: Detyra ime ka qenë n'Bubavec, e thashë. E krewa medresenë, '79-tën kom diplomu. Në '79-tën jam punësu. Edhe bashkë me kohën, edhe n'proceset e '81-shit edhe ma tutje, kurrë ma pa na u nda e keqja. Edhe ajo kohë ka qenë... prej '74 ka qenë pak ni qetësi relative, e përkohëshme, po pa t'drejta t'tua. S'ki pasë t'drejtë ti me mendu ndryshe, pos ni Kosovë në Serbi. S'ki guxu me mendu Kosova me qenë republikë, se, ku guxon Kosova me qenë republikë? Ku guxon me pasë institucione, këtë t'drejtë, e atë t'drejtë? Ti s'ki pasë t'drejtë me pasë akademi, s'ki pasë të drejtë me pasë as ata, as ata, as ata, as ata. S'ki pasë kurrëfarë t'drejte.

Ni pjesë e madhe e këtyne fakulteteve kanë qenë t'ndalume atëherë. Domethanë, ishte ni shtypje e t'drejtave elementare të njeriut dhe nuk ke mujtë me i përballu këto. Ai qe ka lexu, ai qe ka ditë pak ma gjatë, e ka përcjellë situatën. Dhe kam jetu kështu, me këtë situatë, une bashkë me familjen edhe me shoktë. Tu u përpjekë me ba diçka, tu e thanë ni fjalë t'mirë, tu e ba ni punë t'mirë. Tu e fuqizu këtë popull, tu e përgatitë këtë popull qe po na vjen rreziku, edhe si s'na erdh' rreziku? Na erdhi. Na e kemi pa se jemi ka shkojmë drejt ni rreziku shfarosës, Serbia me t'shfarosë, me t'zhdukë nga sipërfaqja e dheut.

Se ka dashtë me marr... nuk i kanë vyjtë njerz të qe i kanë vyejt tokat, edhe xehet nëntokësore me marr, kjo Kosovë plot me minerale, plot xehe, plot arë. Mbi ari jem tu jetu, ju e keni përcjellë, ishte ni intervistë e ni amerikani, thotë, "Ju fleni mi arin e zi." Po mjerisht qe hala s'kemi ardhë deri te ato

zhvillime ekonomike, e plasimi i tyne, nxjerrja, plasimi n'treg t'botës. Po nejse, bohen ato sene, s'janë punë për mu. Dhe kështu qe po thom qe kemi pasë ni situatë shumë t'ranë.

Erëmirë Krasniqi: E qysh ndikojshin qeto ndryshime politike n'punën e jujë?

Mulla Xhevat Kryeziu: Une isha n'kontakt me popullin, edhe isha n'kontakt me masën. Edhe ato reflektonin gjithmonë, "Si t'ia bajmë? Çka do t'bajmë? Çka me gjetë aleancë, me punu." Adem Demaçi ishte n'burg. Ishin ni elitë e intelektualëve n'burgje. Disa herë ishin lëshu, persekutu, disa. Une e kisha shkollën e gatshme, se e kisha te gjyshi im. Unë e disha. Baba im... gjyshja ime ka jetu e vejë. Dhe mas dhjetë vite martesë ia kanë mytë burrin, ka rritë jetima. Dhe unë kam qenë tamon n'shirtin edhe n'mishin e atyne personave qe kanë qenë t'persekutumë. Se kem' qenë vetë familje e persekutume.

Pastaj kanë qenë ato, ato leçitjet qe thashë, largimi ka qenë me masa ndëshkuese. Na i kanë qitë atëhere, thojnë, une nuk e maj n'men, *otkupin*². I kanë tubu t'mirat materiale: ti ki me i dorëzu qikaq mijë tonë grurë, edhe krej ai grurë, edhe ato kafshë, edhe ajo bagëti, janë dorëzu [me] porosi. Edhe koha e *otkupit* ka qenë koha... akcioni i armëve dhe grumbullimi i tepricës, i *vishakut* [tepricë], këto kanë qenë dy periudha famëkeqe për popullin shqiptar. Kanë qenë masë ndëshkuese, m'i përzanë shqiptarët me dalë për Turqi. Edhe memorandumi famëkeq mes Jugosllavisë edhe mes Turqisë, katër qind mijë shqiptarë qe janë dalë n'ato vite, me presion janë shpërngulë nga trojet e veta. Janë shku për Turqi. Tu i thanë Serbia se, "Atje keni fe, atje keni xhamia, atje keni... edhe këtu s'ka ven', edhe lëshone". Edhe kanë ikë, janë përcjellë.

Ju i keni pa këto emisionet qe p'i ban 21-shi, i ka bo para dy viteve ai Bahtir Cakolli me shqiptarët n'Turqi. Nëse i keni vërejtë pak ato përjetimet te ata pleqtë, qysh janë dalë, qysh janë ikë, me kerre t'drunit, me kije janë nisë për Turqi. Dhe janë shku anena, janë gju pamëshirshëm n'shkretina t'Anadollit. Dhe kjo ka qenë tmerr i shqiptarisë. Domethanë tana këto kanë qenë hall dhe brenga t'popullit shqiptar, qe jemi rritë bashkë me to, qi kemi përjetu tmerr bashkë me popullin. Dhe gjithmonë jemi dashtë me u solidarizu me njeni-tjetrin, m'i dhanë forcë, m'i dhanë kurajo, m'i dhanë fuqi qe m'i përballu edhe m'i rezistu asaj, qe mos dalim jashtë, mos t'shpërngulemi, qe t'shkollohemi, qe t'i përballojmë kësaj, se qëllimi i Serbisë... Serbia e don këtë gja: na me ikë prej këtuhit, na mos m'u shkollu, na me qenë analfabetë edhe me bo çfarëdojnë me neve.

Po falë zotit edhe angazhimit, kemi pasë intelektualë, kemi pasë profesorë t'ndershëm, kemi qenë të... jemi solidarizu me veprimet e Adem Demaçit, jemi solidarizu me veprimet e elitës intelektuale qe na kanë mësu, profesorëve tanë, i falenderoj. Na kanë majtë kujtesën gjallë, na kanë mësu për atdhedashurinë. Pastaj edhe familja, asht' edhe ai rrethi ku jemi eduku. Edhe kjo na ka majtë gjallë qe na me e ditë se kah po shkojmë, edhe këto erëna kah po na çojnë neve, edhe qysh me qëndru. Prandaj ishin ato vite, ishin vite t'rana, vite t'vështira.

Erëmirë Krasniqi: Kjo edukatë kombëtare, a ka qenë pjesë e ligjëratave tuja?

² Serb: *otkup*, haraç, taksë.

Mulla Xhevat Kryeziu: Po, edhe kjo ka qenë pjesë e ligjëratave t’ mia, patjetër se pjesë e ligjëratave. Ne kemi përdorë shembuj, raste konkrete çka ka ndodhë me popull ma herët edhe çfarë mund t’na ndodhë. E kemi lidhë, e kemi gërshetu edhe kombëtarën edhe fetarën. Asht’ e drejtë e patjetërsueshme dhe na e kemi thanë kur spjegohet dëshmorë. Asht’ shkalla ma e lartë që e gradon zoti ni njeri që e mbron interesin e pragun e shpisë t’vet, si që e patëm na rastin me Serbinë. Çdo gja që ishte shqiptare... na s’kemi dashtë, e thashë ma herët, s’kemi pretendu t’ marrim territor t’ Serbisë. E kemi mbrojtë pragun tonë. S’kem pasë ku me shku. Prandej ai që vritet, ai që e merr plumbin në gjoks, ai njeri asht’ pi atyne dëshmorëve, që thojmë na pi *sheitëve*³. Gjithçka e pastron ujtë: dorën ndytet, trupi ndytet, ujtë e pastron. Gjakun e dëshmorit e ndytë uji, nuk guxon me pastru atë kufomë. Edhe n’aspektin fetar po thom, ajo kufomë mbetet me kokë shplutë, edhe ai gjak edhe ato tesha pa i ndërru, se asht’ gjaku ma sublim, gjaku ma i shtrenjtë që e pagunë zoti dhe shpërblen me nektarin e xhenetit.

Këto ishin ligjëratat tona, domethanë me e mbrojtë identitetin tand. Se këtë gjuhë shqipe, zoti na e ka dhuru. S’kena ditë na me folë, se kena maru vetë na këtë gjuhë shqipe. Se s’jemi kanë ni tjetër me bo gjuhë shqipe. Kështu kemi lindë na. Edhe tash ta ka dhanë zoti amanet, “Xhevat, e ki gjuhën shqipe.” “Po.” Edhe ata tjetër dojshin me e nalë këta, “Mos fol shqip! Fol serbisht, je burrë i mirë. Puno serbisht, je burrë i mirë. Shqip s’ban me folë.” Pse? I ka prekë interesi. E ka ditë, shkollimi i jonë, gjallëria e jonë, do ta rrezikon ata. Pse? Do të jem na t’zotët e vetit. Ata janë mësu na me qenë shërbëtorë të tyne.

Dhe prandej, me t’a marrë dikush këtë gjuhë ke përgjegjësi para zotit me e mbrojtë, ke shpërblim para zotit. Këta duhet me e pasë t’qartë, gjuhën shqipa ne e ka dhuru zoti. Kush e thotë atje, a Naimi, “Sa e bukur, sa e dliirë, gjuha shqipe sa e mirë”. Domethanë i këndon gjuhës shqipe. E madhështon gjuhën shqipe, se këtë gjuhë na ka falë veç Zoti edhe duhet me e mbrojtë. Edhe e ki për detyrë obligative mos me t’a marrë kush gjuhën edhe identitetin tand. Ti mund t’jesh sot musliman, mund t’jesh edhe katolik, pasnesër ortodoks, pasqetri budist. Amo shqiptar je gjithë, duhet me qenë gjithë. Se[pse] ki gjene shqiptare, gjak. Besimin mund ta ndërrosh, a identitetin, absolutisht [jo]. Prandej, me e mbrojtë identitetin asht’ çështje obligative e zotit. Me dekë për ta, asht’ shkalla me e naltë e xhenetit. Dhe kështu i kemi eduku dhe mësu gjeneratat. Edhe kjo i ka mbajtë, i ka forcu edhe i ka mbajtë gjallë, saqë me i rezistu.

Na kemi qenë këtu n’Kosovë ni popull me dy fe, jemi vëllezër. N’Shqipëri janë tri fe, prapë vëllezër. Besimi musliman, besimi katolik, besimi ortodoks, po gjithmonë vijën e drejtë t’kombit e kemi mbajtë pa plasaritje, pa tendencë t’ndonji përçamje. Ato individuale, ato janë t’izolume. Po domethanë, në masë t’madhe kemi shku mirë. Do t’shkojmë mirë, se ajo kombëtarja na bashkon. Se jem të ni gjuhe, të ni gjaku, të ni tradite, të ni gjeni.

Dhe ligjëratat tona i kanë shërby kësaj kauze. Edhe i kanë shërby jo veç unë, po edhe shoktë e mi. Edhe kështu që kadal dale, tu u ballafaqu me kohën, me proçeset, dadal dale (pa kup.) ajo, kjo, kjo. Pastaj, viteve të ’90-ta, viteve të ’89-ta filloi m’u shfaqë agresiviteti i Serbisë, tash me vra ma shqiptarë. M’i burgosë pak, tash m’i vra. I vrajke studenttë, i vrajke intelektualtë, e vrajke edhe fshatarin, edhe atë

³ Arab: *Sheit*, hero, dëshmorë.

plisbardhin, edhe ata me kravatë, edhe ata me sheshir. Domethanë, tash ma nuk po zgjedhë Serbia se u ban t'gjithë armik për ta. U munu niherë me ba klasifikimin, "Jo këta janë ma t'mirë. Jo kjo shtesë o mirë, po këta janë t'këqi". Po kur e pa që jemi nja, atëhere e shtriu akcionin edhe ma, kond e gjante n'rrugë e shkelke me tenkë edhe e asgjësojke edhe e zhdukte edhe s'don me pa ma gjallë se e kem pengu.

Dhe këto ishin ato problemet që ma vonë, mas këtyne vrasjeve, gjatë këtyne vrasjeve, gjatë këtyne organizimeve t'homazheve, t'pames si themi ne, ka lindë ni iniciativë tjetër e madhe, nga të burgosunit e ndërgegjes politike dhe nga minatorët e nëntokës së Trepçës, erdh' ni kushtrim, si preventivë, si masë me iu përgjegjë këtyne represioneve serbe, me ardhë te uniteti kombëtar. E ai quhej Lëvizja për Pajtimin e Gjaqeve, Plagë dhe Ngatërresa.

Erëmirë Krasniqi: Qysh jeni përfshi ju aty? Qysh ka ndodhë që jeni përfshi?

Mulla Xhevat Kryeziu: Dhe këtu tash, kushtrimi erdh' nga këto dy shtresa: nëpër burgje intelektuale, minatortë ishin nguju n'zgafellë atje. Ju jeni t'ri, s'i keni... ndoshta i keni mbajtë, ose s'i mbani n'mend, jo s'i mbani, jo, jo. Ti kameramani, ndoshta ti?

Noar Sahiti: Ma i ri se kjo.

Mulla Xhevat Kryeziu: A ti ma i ri a? Jo, s'i paske majtë n'mend as ti. Dhe, dhe çka ka ndodhë? Atëhere u duftë me u bashku, me u bashku, me u ba bashkë. Me ia dhanë besën njani-tjetrit. Asht' besa-besa e Haxhi Zekës. Shumë herë shqiptartë para rreziqeve kanë ditë me u bashku, edhe kanë ditë me e lidhë besa-besën, edhe me u përgatitë për ni rrezik qe vjen dhe ish' e përgatitun, i përgatitun në kuzhinat famëkeqe të Akademisë serbe, atyne çubrilloviqëve, e iqëve, iqëve tjerë, për me ardhë deri te asgjësimi dhe shfarosja e këtij populli. Historikisht qe ka ndodhë edhe ma herët. Edhe ma herët qe ka ndodhë. Domethanë, nuk ka qenë presion veç në '81 e knena, po historikisht, historikisht ky popull ka derdhë gjak.

Dhe erdh' momenti qe t'formohej Lëvizja për Pajtimin e Gjaqeve. Këtë Lëvizje e morën shtresa më e mirë e asaj kohe. E ata ishin, ishin engjujt e asaj kohe, studentat. Studentat janë shtresa ma e mirë e ni populli. Janë t'padjallëzumë, janë filiza t'ri qe shkollohen, qe pritet ardhmëria e tyne, qe pritet angazhimi, pritet kontributi i tyne. Edhe ata, pikërisht t'ritë e fshatit Lumëbardh, me 2 shkurt t'vitit 1990, ka fillu ni... me u marrë ni besë, dy-tre mujë, pastaj ni plagë, pastaj ni gjak, edhe kështu qi tu u konsolidu rradhët, tu u formu Këshillat, dhe gradualisht u bamë ni armatë e tërë edhe ia fillumë akcionit, ku ky akcion pra kishte suksesin, ky akcion u kurorëzu me shumë afrime, bashkime, pajtime.

Une kur fillumë, dikun kah 2 shkurt ka qenë në Lumëbardh, fillumë me u lëkundë, çka po ndodhë, çka duhet me ba. Edhe une për herë t'parë e kontaktova Anton Çettën në ni intervistë në televizor. Dhe ja çka, ajo qysh e kuptova unë... dhe Antoni thotë, qe une kontaktova me ta n'televizor, po thotë Antoni, "Njani ni kohë e kishte ba ni trimëni edhe filloi populli, rapsodtë [sic] qitën kangë edhe p'ia knojnë kangën atij zotnisë. Dhe ni ditë pi ditësh, qellon ai ni aheng aty. Erdh ni darsëm ni diçka, edhe fillunë rapsodtë me ia knu kangën. Edhe ai kur e ndigjoj kangën e vet edhe e nxurrë revolen edhe po qet

përpjetë. Ni plak i meqëm aty thotë, “O, ma bre. T’vraftë zoti, çka bane kështu bre! Se e vrave kangën tane.” Edhe kurrë, prej atij momenti s’iu knu kanga atij njerit ma. Njeriu ka mundësi me e vra kangën e vet n’jetë. Prandej, s’është mirë me iu këndu prej s’gjalli, po le t’i këndohet masi ta mbyllë gjysëmvetorin e dytë qe thojmë na. Kush del n’amshim, kush del prej kësaj bote, se për s’gjalli nuk i knohet kanga, se njeriu ka mundësi me e vra kangën e vet.” Për herë t’parë e pava Anton Çettën.

Po lëvizë, filloi akcioni te studentët, filloi n’Pejë, hajde tash ç’t’bajmë? Filloi tash iniciativa nëpër kuvende komunale. Dhe u themelu edhe aty ku jetoj une, në Malishevë dhe më thërrasin. Kohë ma parë, me 31, bahet tash... sot asht’ data 26, i 26-ti sot, me 31 janar t’këtij vitit 1990 vrahët Ali Kryeziu në Malishevë, vrahët Abdullah Mazreku në Malishevë, dhe plague edhe ni tjetër që sot s’dihet, edhe njëmdhetë t’plagosur aty prej forcave t’barbarisë serbe. Aliun e kisha t’afërt, babëgjyshat i kishim vëllazën. Babëgjyshi i Aliut edhe i imi ishin vëllazën, dhe une e organizova bashkë me kushëritë e vëllazërlakun, e kom organizu t’pamen, vorrimin. Edhe kur filloi Lëvizja më thirrën mu, “Mulla Xhevat, a po vjen n’Këshill me na nimu se kontributi yt asht’ i madh, edhe na duhesh.” “Po more, patjetër.”

Edhe jam shku edhe kam fillu bashkë me shokët. Kemi pasë suksese. Dhe ma bajnë ni ftesë, me 20... me 14 prill n’vitin 1990 mbahet n’ditën e Pashkëve, në kishën e Zllakuqanit mbahet ni tubim fetar, po qe lidhej dhe disa pajtime t’gjaqeve aty. Edhe une marr pjesë si musafir. Aty ishte me 14 prill. Dhe atëhere kam marr obligim, une ta baj... se tash, aty ku bahej pajtimi, nëpër lokale, oda, ma tash ishin t’vogla ato. Filloi me u rritë akcioni. Filloi kërkesat, njerëzit e pritën me entuziazëm. Njerëzit kishin dëshirë me ba diçka. Dhe atëhere odat ishin t’vogla, oborret e vogla. Jam detyru une me e ba organizimin për pajtimin e gjaqeve në xhaminë e Bubavecit, ku sot quhet Xhamia e Pajtimin, e kemi emëru. Dhe aty...

Erëmirë Krasniqi: A u mbajt pajtimi i Zllakuqanit?

Mulla Xhevat Kryeziu: Po, u mbajt e Zllakuqanit. Tash po du une me e imitu Zllakuqanin, dhe po du diçka kështu me ba. Ishte rrezik, se ishim n’gjendje t’jashtëzakonshme. Nuk kishim t’drejtë tre shqiptarë me u ba bashkë. Duhesh nxjerrë leje pi organeve t’shërbimit policor. Mjerisht ata, akoma ishin hala, i kishin do kompetenca policia, akoma hala. Dhe unë duhej... katër-pesë ditë përpara ishëm përgatitë me u falë 27 gjaqe n’Bubavec, e disa plagë e ngatërresa. Kishum grumbullu na. Kishum përgatitë për me ardhë mu ba falja zyrtare aty. Dhe këshillohem me shokë, une duhej me shku me lajmëru organet. Ishte ni djalë, ni Faik Jasiqi nga rrethi, tash komuna e Junikut. Kishte ardhë punëtor i ri në Malishevë, komandant policie. Ishte ndërru ni tjetër. Nuk më njifte, as nuk e njifsha.

Thashë, “Zoti komandant, kam një kërkesë...” ishte me 26 prill, dita e Bajramit, “dhe e kam ni diçka t’veqantë, ka mu falë ni gjak aty e veç erdha me t’kallxu, a din?” Tha, “Mirë, mirë. Ti emrin Mulla Xhevat? Mulla Xhevat,” tha, “tregomë ti mu krejt qëllimin e aksionit.” Kish ni ai, u folke në Bubavec, “Do të bahet në Bubavec, në Bubavec.” Se ishte atëherë diçka me ndodhë, kishim dëshirë dikush t’bën diçka, t’lëvizim diçka. “Po ju komandant, po ni gjak ka m’u falë, ni plagë, jo diçka.” “Jo, jo, jo, ti duhesh me m’kallxu mu.” Dhe tash une, me i kallxu, nuk i besojshna. Mos m’i kallxu, kishte dëgju ai. Çka me

ndodhë? “Komandant,” thashë, “po mirë bre, Dita e Bajramit, vijnë njerëzt aty. Po t’kallxoj, ka me u falë ni gjak bre burrë, s’ka edhe diçka tjetër.” Tha, “Jo, jo, duhesh me m’kallxu.” “Epo, po t’kallxoj.”

Kur m’tha ai, “Dëgjo Mulla Xhevat, unë do të vij në Bubavec me patrullën time.” Kishin shku masat e dhunshme në stacion t’Malishevës. Kishte serbë, kishin ardhë nga Serbia, nga Bosna. M’duket gaboj, jo nga Serbia, nga vendet tjera, Vojvodinë. Thotë, “Une ata du me i lëshu n’pushim dhe une du me marrë aksionin, përgjegjësinë edhe me ardhë me t’mbrojtë ty edhe atë pjesë aty edhe pa u vra unë, kush s’ka me u vra.” Eh çka po m’del këtu! Edhe une i tregova krejt çka ka me ndodhë. “Kemi thirrë shumë njerëz. Kanë me u falë disa gjaqe. Le ta majmë aty tani naj kangë, recital, kish aty binë, aty ishte edhe ni tubim”.

Edhe ndodhi kjo. Me 26 prill viti 1990, dita e Bajramit, sa e falëm Bajramin, e kishim bo na binën, mjetet e zmadhimit t’zanit, kishum shkru pankarta në derën e xhamisë që nuk e harroj kurrë, ishte e shkrume një parullë. Edhe e shkrunte Muhamet Pirraki, ndjesë pastë. Profesor Antoni i thotë, “Muhamet, kjo a’ e randë për Mulla Xhevat: mos shikoni kisha, mos shikoni xhamia, se feja e shqiptarisht osht’ shqiptaria!” N’derë t’xhamisë t’Bubavecit. “Mulla Xhevat, çka po thu ti?” Thashë, “Profesor, e randë osht’ pak për mu, po e don koha. E don koha se na duhet me u kthjellë se jemi para ni rreziku t’madh”.

Edhe çuditërisht kjo parullë ka qenë që disa kolegë t’mi ma kanë pa për t’madhe, “Në xhami të Bubavecit o shkru: mos shikoni kisha...?” Nuk o qëllimi mos m’i shiku kisha, xhamia. Se ato janë objektet tona fetare që njeriu e shpreh vullnetin, e besimin, e dëshirën aty. Nuk ish’ mesazh mos shikoni, po ish’ mesazhi mos u përçani për kisha e xhamia, se feja e shqiptarit asht’... që domethanë si çështje obligative, e rëndësishme, parësore ishte na të forcohem edhe t’hjekemi prej okupimit serb, t’a dimë atdheun, t’a bajmë shtetin, po atëhere fenë e ki t’lirë, urdho dhe ban çka t’dush. Kjo ishte.

Po dikush, ai që nuk ka pa larg, që ka pa vetëm kështu {i vendosë të dy duart anash syve}, ma ka pa për t’madhe, “Qysh Xhevati.” Dhe çka ka ndodhë këtu... diçka tjetër. Në këtë xhami, ditën e Bajramit pesë prifta kanë ardhë në tubimin e pajtimit t’gjaqeve. Kanë qenë pesë n’binë, se dhetë a nizat kanë qenë poshtë, tjerë n’masë si spektatorë.

Pjesa e Dytë

Dhe ma kanë pa për t’madhe, pse qysh me shku hoxha n’kishë, se s’ban me shku n’kishë. Prandej këtu asht’ ajo thelbësorja që e kom ba unë, që e kom ba ni urë, i kam lidhë dy kulte fetare që me kqyrë njana-tjetrën, kishën edhe xhaminë mes veti, hoxhën edhe priftin mes veti. Për m’i kallxu botës se s’jemi popull fundamental, terrorist, as kriminel. Se islami nuk e rrezikon kend, as në Kosovë, as n’Ballkan, as n’Evropë, as n’botë. Se jemi fe tolerante, fe toleruse, se e kemi bashkëjetesën, se jemi vëllazën. Tri fetë dalin... janë te ni... i bartë ni popull. Edhe ky ishte ai mesazhi kryesor që njihej tubimi i Bubavecit.

Dhe çuditërisht, tremdhetë herë jam arrestu prej forcave serbe. T'tremdhetat hera e kom pasë t'njejtën pyetje, "Çka ke lypë ti n'kishë? Çka kanë lypë ata me ardhë n'xhami? Pse jeni bashku? Pse jeni pajtu? Doni me na sulmu neve?" "Jo, na s'dojna me iu sulmu, po qe osht' nevoja na dojna me u mbrojtë pi jush. Me iu sulmu asesi, a m'u mbrojtë na po. Se s'jem tu ardhë n'Serbi me sulmu kerkend, absolutisht. Kerkund s'kem pretendime territoriale. Kem me mbrojtë nderin tonë." Edhe kjo ishte aja fuqia, aja madhështia e Lëvizjes. Ajo u përhap në gjithë Kosovën, edhe jashtë Kosovës. Pastaj une kam dalë...

Erëmirë Krasniqi: T'ndalemi pak te pajtimi i Bubavecit, sa raste janë pajtu, sa njerëz kanë qenë prezent?

Mulla Xhevat Kryeziu: Tubimi i Bubavecit, n'atë ditë janë shënu 27 gjaqe të falura. Janë shënu dikun rreth 40 plagë dhe ngatërresa. Domethanë, janë ba komplet rreth shtatë-80 pajtime. Dhe kemi pasë ni pajtim për çudi, kemi pasë dy raste. Do t'i përmeni dy. Njeni, në një fshat n'periferi t'Malishevës, iu kishte vra djali mësues. E kishte vra ni kojshi i veti, ni fqinj i veti. Edhe kur shkumë na, dhe ai kur shkumë na aty, atij qe i shkumë na, qe iu kishte vra djali mësues, ni familjar i asaj shpie e kishte vra edhe ai ni kojshi tjetër. Edhe ishte i vramë pi dikujt edhe ishte vrasës i dikujt. Çka ndodhi këtu? Shkumë na te ajo familja tjetër, me ia pru faljen këtij ma s'pari. Shkumë n'Suharekë edhe ia prumë na faljen edhe atë njerin me veti, me ardhë edhe me ia shtri dorën atina, "T'qoftë falë gjaku i vëllavit!" "Qofshë me ner e njerzi, zoti t'neroftë!" Na duartrokitje, u gëzumë pa masë.

Dhe tash p'e pimë ka ni kafe, po pushojmë. Po don profesor Antoni kadal dale tash me i dalë [përballë], "Ky ta fali ty, tash edhe ti duhet me ia falë atij tjetrit." Tha, "Bac," "Urdhno profesor!" "tash more vëlla i dashur ka ardhë rradha edhe ti me e ba ni gajret, me ba ni ner n'emër t'zotit, e t'popullit, e t'flamurit, e t'martirëve, e t'dëshmorëve: me falë gjakun e djalit tand." "Jo more profesor, kjo punë nuk bahet kollaj. Nuk falet gjaki i mësusit. Ky a' ka mësus. Gjaki i mësusit nuk falet." Dikur tha, "Po ky ta fali ty." "Ani, ani, ky ma ka falë, po ky s'e ka pasë mësus." Ishte e ranë për ne m'i thanë njeriut, "Ky s'ka pasë, se s'koka kanë mësus [djali] i tina, djali i tij s'koka kanë mësus." E ajo për neve ishte e ranë, edhe ato vëllazënit e tina, "Ma bac, se na e more ftyrën. Ma bre bac, se nuk ban kështu. Po, a je normal bre? Po shpirt i joni, shpirt i tina." "Po, po, ama djali jem u kanë mësus, e gjaki i mësusit nuk falet. Ti Anton a e di çka osht' mësusi? "Une po t'kallxoj ty, une jam baba i mësusit." "Pse?" "Une jam ai qe kom krijua, kom prodhu gjenerata. Une e kom mësua atë djalë tanin. Une t'a kom ba mësus, se jam mësusi i parë n'Kosovë." "Ti s'pe dishe mirë çka osht' mësusi".

Edhe kështu qe katër-pesë orë punë intenzive dhe nuk mujtëm me e bindë atë person. Po çka ndodhi? Ndodhi, pasi që jemi largu ne, është organizu tubimi në Xhaminë e Pajtimit, n'Bubavec. Dhe familja, familjartë e rrokin se, "Na ke marrë ftyrën edhe qysh u solle kaq keq, edhe për hatër t'popullit, për respekt t'kombit, e t'dëshmorëve, e t'familjes duhesh me falë." Edhe u çu o ardhë n'xhami t'Bubavecit. Edhe po na thërret, "O Mulla Xhevat! Baci e ka falë gjakun e mësusit." "He, qoftë me ner!" Kur o ardhë momenti m'u përqaftu, "Profesor, qe edhe ky baba do me t'a shtri dorën." "Ky kush o?" "Ky osht' baba i mësusit." "A, baba i mësusit!" Atëhere t'ia ka ngjtitë edhe e ka përqaftu. Kurrë s'e harroj, edhe tash dytë janë n'botën e gjatë. Edhe ishte kjo ni e veçantë.

Ni rast tjetër n'xhami t'Bubavecit. Njeni thotë, "Une du me falë." Se ishte vrasje në mes dy besimeve. Kishte vra i besimit katolik besimin musliman. Dhe besimi katolik osht' shpërngulë edhe o shku n'Kroaci me jetu. Ky besimi musliman thotë, "Une du me falë, po me ni kusht." Na, "Ma bac, ma bre mos na vno kushte, ma bre." "Ja, ja, une e kam ni kusht." "He?" "Nëse kthehet ai prej Kroacisë me ardhë n'Kosovë, mos me lëshu venin e vet, une du me ia falë." Kjo ishte e madhe për ne, p'ia fali me ardhë pi Kroacisë, me lanë Kroacinë, me ardhë n'vend t'vet ku ka jetu, mos me lëshu atdheun e vet. Kjo ishte për ne madhështore edhe na jep fuqi që me punu edhe ma tutje.

Edhe kjo, domethanë këto dy raste kanë qenë raste t'veçanta që janë në kujtesën time dhe që i maj. Ka pasë shumë kujtime. Ka pasë shumë raste. Ishin dikun, simbas profesor Pirrakut ndjesë pastë, dikun tre qind mijë njerëz kanë gravitu. Tubimi ma i madh që e mbaj mend pas Luftës të Dytë Botërore deri atëhere, i Bubavecit. Dhe ka qenë dikun dhetë kilometra, n'katër anët e Bubavecit: n'drejtim t'Prishtinës, n'drejtim t'Pejës, n'drejtim t'Malishevës edhe n'drejtimin e Suharekës. N'katër anët rrugtë... s'kanë mujtë njerz të, kanë ardhë. Ka ni orë e gjysë kanë bo n'kamë me ardhë n'Bubavec, s'kanë mujtë pi makinave. Domethanë, sa masë e madhe, por hapësirë e vogël, e njerëzit janë tubu. Se dikun dulë mbi tre qind mijë njerzë. Dhe ma pastaj, masi u kry tubimi aty, une e kom shpallë me intervenimin e t'rive të Deçanit, e kom dhanë kumtesën, "Mirupafshim me 1 maj, te Verrat e Llukës".

M'u dha rasti që une me e dhanë lajmin se me 1 maj 1990, do t'shihemi te Verrat e Llukës. Verrat e Llukës, o fshati Llukë në komunën e Deçanit. Aty asht' mbajtë ni tubim, asht' mbajtë aty ni kuvend i gjithë shqiptarëve. Janë marrë vendime t'randësishme. Pastaj u ba Kuvendi i Dytë i Besëlidhjes, ose i Pajtitimit, ose i unitetit, ose i bashkimit. Dhe aty pat', tash akcioni u shtri edhe ishte koha e mirë, edhe informacioni u ba i madh para tre qind mijë njerëzve, edhe e banë tani edhe mediat, edhe kështu që arriti kulmin. Dikun rreth gjysë milioni njerëz të tubohen në territorin e Llukës, te Verrat e Llukës, ku u falën aty dikun mbi 60 gjaqe. Dikun rreth 30 gjaqe... tash është që 26 vite, shtatë, paksa për mu kohë e gjatë, që s'kam mujtë me i majtë n'mend. Po dikun rreth 30 gjaqe janë falë pa intervenu. Veç u çojke pi masës edhe vite e çojke dorën, "Hajde!" "Unë du me falë gjakun..."

Ishte ni rast i veçantë, dulë ni motër shqiptare, qoftë e nderuar sot e asaj kohe, "Une du me falë gjakun e t'vetmit vëlla n'emën të gjashtë motrave." Ai tjetri, "Une du me falë gjakun e vëllavit." Ai t'djalit, ai t'babës, domethanë kem arritë... sensibilizimi, vullneti për me ba diçka, angazhimi për me vnu ni gurë n'kalanë ma t're t'kohës sonë, t'historysë tonë kombëtare. Pra 30 e sa gjaqe janë ba aty për aty, pa u kërku, pa pasë mundësi me shku me kërku falje n'ato familje. Këtu ishte ajo e veçanta e tubimit të Verrave të Llukës. Domethanë, u banë mbi 60 e sa.

Dhe aty, kur e pa Serbia këtë masë t'madhe edhe këtë fuqi t'madhe mbi gjysë milioni, Serbia na rrethekoi me tanka në Verrat e Llukës. Edhe aty për pak, falë zotit dhe angazhimit, sakrificës t'profesor Zekeria Canës që kam ni respekt për ta, ai e ka ndalu pa u ba ni masakër, ni gjakderdhje e madhe prej forcave të Serbisë deri te ne. Shumë njerëz janë rreh, shumë janë maltretu, disa janë burgosë edhe kështu që...

Erëmirë Krasniqi: Qysh e ka ndalu?

Mulla Xhevat Kryeziu: Me masa represive, me tenka, me polici. Domethanë masi u kry, fillunë me i marr aktivistë, fillunë me i rrahë aktivistë, me i rrahë njerëzit, fillunë m'i maltretu, m'i burgosë. Edhe e pa se aty populli e ka përnime, edhe ajo për Serbinë ishte ni bombë kundër saj. Edhe aty murr masa ndëshkuse, edhe ma nuk na ka lanë me majtë tubime t'mëdha, qysh i majshim ma herët.

Erëmirë Krasniqi: Mendova Zekeriaja, qysh ka mujtë me i ndalë?

Mulla Xhevat Kryeziu: Profesor Cana ka... ngase populli jonë bante me dy gishta {i ngritë dy gishtat lartë}, viktoria. Bile mu m'kanë pytë, "E cili është karakteri i këtyne dy gishtave?" Tani une i kom shndërru me ni simbolikë tjetër. Kom thanë, "O t'gjallë e n'liri {e prekë njërin nga dy gishtat e ngritur}, o t'vdekun e n'xhenet {e prekë gishtin tjerët}. Po n'cilën t'jem, mirë do t'na bjen. O t'gjallë n'liri, o t'vdekun n'xhenet." Domethanë, qe edhe dojmë me dekë, po xheneti tani. Edhe disa media e kanë marrë këta, e kanë shkru.

Serbia n'fillim, te akcionet... po hi tash te karakteristikat e Lëvizjes, që janë t'shumta ato. Serbia në fillim ban propagandë se "shqiptartë janë vrasarë, vetë janë vra, s'kam gja t'bah këtu, pse këto sene me i ba, janë t'prapambetun." Edhe propaganda e Serbisë ka vazhdu edhe në vrasjen e njerëzve pas Lëvizjes, ose qe i vrante njerëzit viteve të '89-ta, qe u ba vrasja e njerëzve, e intelektualëve. Po, se, "Shqiptartë vetë janë vra. S'p'i vrajke kush, po vetin e vrajnë. Se ata janë qe marrin gjak, qe nuk lanë gjak." Edhe do komente banale, tu na ofendu autoritetin edhe punën e angazhimin tonë. Dhe Serbia me çdo kusht don me e zbehë, me i dhanë konotacione negative këtij misioni edhe me zhvlerësu.

Mirëpo bota e pa. Kemi pasë për fat të mirë që kemi pasë njerëz nga Evropa, kemi pasë njerëz nga Amerika, e kanë përcjellë situatën ma afër, edhe e kanë kuptu, edhe e kanë ditë çka po bohet. Ka qenë ni diçka interesant, gjatë këtyne tubimeve, ishte shkurorëzimi me partinë komuniste. Organizojshim, lajshim tavolina, edhe aty nënshkrime, m'i dorëzi librezat e partisë komuniste. Ajo ishte për Serbinë, se n'emër t'partisë e ka majtë situatën me aktivisë e me komuniste. Dhe ma e bamë ata qe me e bindë masën dhe opinionin, popullatën me i gjujtë ato librezat, mos me pasë ma kunorë me Lidhjen Komuniste, se ishte tmerr për neve. Edhe kjo ka qenë e fuqishme. Pastaj...

Erëmirë Krasniqi: Kur ka ndodhë kjo, n'cilin vit?

Mulla Xhevat Kryeziu: Viteve të '90-ta, fillimi i viteve... tubimet e kanë pasë atë efektin. Ka qenë e bujshme, ka qenë atraktive për atë kohë, ka qenë diçka shumë e shejtë me ba diçka. Pastaj kishte karakteristikë tjetër, si veprimtarë n'Lëvizje, ne i kemi kalu dy norma, i kemi tejkalu. Ose s'jena marrë me ato dy norma qe janë marrë ma herët, qe kanë qenë norma kanunore, që është pagu gjaki me lira, edhe i kemi kalu normat sharlatike, prapë qe është pagu gjaki n'vlerë t'ni qind deveve, ni gjak i ni njerit. Ose u pagu plaga, u pagu ajo. Domethanë, kemi ba pajtime pa kushte. Nuk ka pasë dëmshpërblim. Ai qe e ka falë, e ka falë n'emën t'zotit, n'emën t'kombit, n'emën t'lirisë, n'emën t'atdheut, n'emën t'karaktetit t'familjes t'vet. Këtu s'ka pasë ma me u pagu gjaku.

Ka qenë karakteristikë tjetër qe na si veprimtarë, si pajtimtarë nuk kemi qenë me mëditje. S'na ka çu kërkush. Kemi shku me makinat tona. Kemi shku me shpenzimet tona. Kena shku me dreka, darka

tona. Ka qenë diçka shumë e veçantë që kurrë n'atë familjen që ka vra s'kemi hangër bukë, s'kemi dashtë me ia hangër bukën atina. Ia kena çu t'falën, "Falë t'qoftë, filani ta ka falë, s'ki gja t'keqe me ta." Bukë s'kena hangër aty. Kemi dashtë me neru këtë familjen e damtume. S'kena dashtë me i ba qejf asaj familjes. Edhe ai na ka falenderu dhe nuk na ka porositë kur shkojmë.

Ka qenë diçka tjetër, për me pasë sukses akcioni kemi shku... ju m'kuptutë që thashë shtresa ma e mirë e kombit, ni elitë e studentëve, shtresa me e padjallëzume, që thojmë na, ma e pastër n'aspektin shpirtnor e moral. Nuk kemi marrë as dajë, as mik, as nip, as tezak me na nimu. Jo, jo, tanë i kemi eliminu. Kush na u ka bashkangjtitë, iu rritë nera. Po na s'kemi thirrë. Kon e ka shok Mulla Xhevati, kon e ka dajë, ja absolutisht. Ka hi mrena grupi, "Kemi ardhë n'emën t'zotit, n'emën t'kombit, n'emën t'gjakut t'dëshmorëve, n'emën t'nanave, n'emën t'djepave, edhe me na falë." Edhe kështu gradualisht i kena bindë atë zotninë me falë, me iu zbutë zemra, e me ba diçka për çashtjen, për kauzën tonë kombëtare.

Domethanë, nuk kemi pasë shpërblime. Këtu ni gjermane e ka mbrojtë temën e doktoraturës: Lëvizja e Pajtitimit t'Gjaqeve e viteve të '90-ta. Edhe bisedumë me ju Jetë, e ka atë libër, hala si ka dalë pi shtypit. Ajo ka tubu shumë material. Nja 30 shokë që ia kam çu unë, "Shko edhe te filani, edhe te filani." Domethanë, atë rrjetin që kemi punu na me ta. Edhe ajo ka tubu shumë nektar t'kësaj lëmie. Ishalla don zoti del naj libër ma shpejtë, e ka shumë material aty. Se ka tubu prej veprimtarëve që i kanë rujtë n'kujtesën e tyne. Edhe është... ka me dalë ni libër i mirë.

Ne i kemi ba disa libra, asht' libri i Institutit, asht' libri i doktor Muhamet Pirrakut, asht' libri që e kam ba unë, asht' libri që e ka ba ni djalë i Ferizajit, asht' libri që e ka ba edhe Bajram Hoti. Janë nja pesë-gjashtë libra deri tash që janë botu, po karshi asaj çka asht' ba o shkru shumë pak. Se m'i pasë ndodhë ni popullit t'Gjermanisë, Austrisë, a Italisë, a t'Francës ky fenomen, kish me pasë biblioteka të tëra me libra. Po mjerisht që s'jemi marrë seriozisht hala me këtë veprimtari. S'jemi marrë hala si duhet. Me ba analiza, me ba edhe m'i shkru senet, m'i tubu senet edhe m'i vendosë aty ku e kanë venin.

Dhe ajo gjermanja, e ka marrë, kur na pytke, "Mirë n'qitë akcion ju që shkutë, kush iu jepke pare?" "Me pare tona. Makinat t'tonat. Dreka e jona." "Jeni pagu?" "Jo, s'jemi pagu." "E qysh me punu ashtu? Sa vjet?" "Kena punu, une për shembull personalisht që 26 vite s'jam nalë, dej natën e pramit. Edhe pramë kam qenë në një akcion." S'jom nalë që 26 vite, kurrë. N'shpenzime tona, s'kemi marrë ni cent pi kujt. Ka fjalë, ka pi atyne gojëkëqive, pi atyne që iu ka çartë kumbaria, njerëz që kanë pasë privilegje e sene. Dojnë me etiketu njerëz, "Jo po marrin pare, jo kanë marrë pare." Po une me shoktë e mi, me qata që kena punu, kena punu që thojmë na n'mënyrën ma t'sinqertë, n'mënyrën ma shpirtnore, n'mënyrën ma humane. S'i kena marrë kujna ni cent. As kafen bre thashë se kena pi, e leje ma me marrë pare, me marrë mito diçka. Edhe këtu e ka pasë, këtu ka qenë ajo madhështia e akcionit, që kemi qenë t'përkushtumë n'mënyrë shpirtnore me ia ba ni hajr, ni t'mirë këtij kombi.

Erëmirë Krasniqi: Kush kanë qenë bashkëpunëtorët e jujë t'afërt, akcionin ku e keni fillu?

Mulla Xhevat Kryeziu: Une e fillova akcionin në Malishevë, dhe kur e panë angazhimin tim në Malisheve, atëherë mu profesor Anton Çetta m'ka marrë gjithkrah me veti. Edhe kemi shku edhe në Amerikën e largët. Edhe atje i kena bo 20 e sa pajtime. Kemi qenë: profesor Anton Çetta, profesor Zekeria Cana, profesor Mark Krasniqi, profesor Muhamet Pirraki, profesor Tahir Abdyli, profesor Limon Rushiti, profesor Hakif Bajrami, profesor Musa Limani. O janë ni ushtri e tërë që është shumë me i përmën emrat. Këtu, pastaj grupi i Pejës: Have Shala, Mirvete Dreshaj. Ka qenë tani grupi tjetër: Nuriye Zeka. E pat' ni fatkeqësi edhe dikush ata e eliminoi nga sipërfaqja. Vitin e kalumë e patëm ni akademi për ta. Edhe sot është vdekja e saj enigmatike. Ka qenë ni veprimtare jashtëzakonisht e dallume.

Erëmirë Krasniqi: Edhe kjo e rrethit t'Pejës?

Mulla Xhevat Kryeziu: Po, e rrethit t'Pejës. Kanë qenë rinia e fatit Lumëbardh. Domethanë, u shtri akcioni. Edhe n'bazë t'i analize me profesor Antonin, njerz të që kanë qenë aktiv sillej numri dikun rreth pesë qind, n'Kosovë.

Erëmirë Krasniqi: E n'rrethin e jujë n'Malishevë?

Mulla Xhevat Kryeziu: N'rrethin tem t'Malishevës ka qenë... e kom pasë Fetah Bekollin. Na kemi qenë në Malishevë: Fetah Bekolli, ai që e ka inicu, që e ka udhëheqë Avdyl Berisha. Pastaj u kanë Hamëz Kryeziu, Brahim Kryeziu, Cen Desku, Januz Mazreku, Kumrije Bashota, Xhevdet Kastrati, Ragip Shala, Hasime Mazreku, Zyrafete Krasniqi, edhe shumë e shumë. Domethanë, kemi qenë dikun... mësusi Sherif, veteran i arsimit Sherif Gashi. Dhe kena qenë t'gjitha profileve. Dhe kështu që dikun n'rreth t'Malishevës i ka pasë dikun rreth 30 veprimtarë.

Erëmirë Krasniqi: Ata i mbledhshin t'dhanat?

Mulla Xhevat Kryeziu: Ata na i mbledhshin t'dhanat nëpër fshatra. Për shembull, n'fshatin Bubavec ishte ni gjak, ishte ni ngatërrësë, në kit' fshat, n'atë fshat, domethanë, mbledhshin t'dhana. Edhe tani na grup, t'organizimë kemi shku derë më derë. Sikur ajo bleta që e tubon nektarin lule më lule, qashtu i kemi grumbullu kadal dale t'dhanat, shënimet. E bajshim orarin, u dajshim n'grupe. Herë të gjithë, herë ka shtatë a tetë. Kështu që vërtetë e kena ba ni punë shumë t'madhe, ni punë shumë t'mrekullushme. Kjo Lëvizje i dha forcë popullit, kjo Lëvizje e shtyri popullin me mendu situatat tjera ma t'randa, edhe këtu na gjetë t'përgatitun situata ma e re, ose që lindi ni krijesë e re, krejt e re, që quhej Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Këtë popull e gjetë t'bashkumë. Këtë popull e gjetë unik. S'kishum dallime partiake, as krahinore, as regjionale. Ishum ni popull me ni shpirt shumë t'mirë, atëherë. Tash s'jemi ma ata. Tash, s'jemi ma.

Dhe kemi qenë tanë ushtarë t'asaj kohe, pa u dallu. Çuditërisht që nuk ka pasë kryetar, as sekretar, as gjeneral, as pa gjeneral. Kemi pasë vetëm unitet, bashkë me shkue. E kemi pasë Antonin që na ka pri, e kemi pasë Antonin që e kemi nderu, edhe me pleqërinë e tij na ka nderu. Po me thanë osht' kryetar ky, jo. Domethanë, ka qenë plaku i urtë i Kosovës, plaku Anton Çetta, që ka qenë gjithmonë përkrahë rinisë studentore, shtresës intelektuale edhe atyne që kanë dashtë me ba vepra të mira në këtë Kosovën tonë.

Erëmirë Krasniqi: Kur u përfundunë pajtimet, kështu ma zyrtarisht?

Mulla Xhevat Kryeziu: Jo, pajtimet... tubimet, kuvendet, kanë përfunduar me Kuvendin e Verrave të Llukës. Se Serbia ma e pa vullnetin dhe gadishmërinë tonë. Edhe asaj i erdh' ranë kjo punë pse na jemi bashku ni gjysë milioni, pse jemi bashku edhe pse po i bajmë këto sene na. Edhe aty ajo me ironi tani i shtypke edhe demonstratë, edhe protestatë. Edhe vazhdimë protestë mas proteste, deri te organizimi i Ushtrisë Çlirimtare t'Kosovës. A vrante shqiptarë, a burgoste shqiptarë, masa represive, masa tjera t'rana. Rinia largohej masivisht nga trojet e veta, e suprimoi autonominë, i mbylli shkollat, i mbylli institucionet. Gjithçka çka ishte shqiptare, e mbylli. Gjithçka çka ishte shqiptare! Dhe s'patë tjetër, asht' dashtë me ardhë ni krijesë e re, ni forcë e armatosur qe me iu përballu atyne sfidave t'rana. Asaj e kemi ditë qe ka me na kushtu, e kemi ditë qe kemi me u vra. Kemi ditë qe kemi me derdhë gjak, po s'kem pas ku t'shkojmë përtej shpiave tona.

Erëmirë Krasniqi: Mas Verrave të Llukës, a keni vazhdu ju me pajtime?

Mulla Xhevat Kryeziu: Jo mas Verrave të Llukës, po qe 26 vjet Lëvizja e vazhdon punën e vet. U majtë kuvendi i parë, u majtë kuvendi i dytë, u majtë kuvendi i tretë. Në vitin '95, në nandor të vitit '95, ka vdekë me katër nandor i nderuari profesor Anton Çetta. Edhe tani këshillat kanë kalu në nivele lokale, tani kanë kalu disa pleqni. Po ai karakteri i fuqishëm i asaj Lëvizje ma tani ra. Se na ni punë t'madhe e bamë, edhe ni pjesë e madhe e gjaqeve u falë. Ni pjesë e madhe e popullit u pajtu, edhe deri qe hymë në luftë. Shtrohet pyetja, po t'ishum futë n'luftë me këto hasmëri mes veti, çka kish me ndodhë? Kish me i hupë kuptimi luftës. Serbia kish me thanë, "Po vriten mes veti, janë tu ba luftë mes veti, po vrahën, se s'p'i vret Serbia." Kjo ka qenë ajo ma e rëndësishmja qe na e kemi ba se për mos me thanë Serbia qe, "Po vriten vetë, e s'po i vrasim na." Po na u pajtumë, u bashkumë edhe ku kërshitke pushka e shkaut u dike se nuk kërshitke ni gjak shqiptari.

Na ishëm bashku, ishëm pajtu. M'u pasë futë n'luftë kështu, sa viktima, sa vrasës kishim me u ba t'u marrë hak njani me tjetrin, kish me hupë kuptimi i luftës. M'u kthy tash me luftu mes veti na, m'u nda n'grupe me luftu mes veti. Prandaj, ky ishte qëllimi i asaj qe ne ditëm me u bashku para kësaj situatë t'randë: me u ba bashkë edhe ato pushkë mos me i drejtu kah njani-tjetri, kah vëllavrasja, po me i drejtu kah armiku. Dhe çka bamë këtu? Dhe bamë këtu se hapëm shkolla t'reja, se mbyllëm varre, se hapëm universitete.

Pjesa e Tretë

Janë falë dikun, ni statistikë, nashta krejt s'është e saktë, dikun rreth 30 mijë pajtime qe janë ba. Me t'u pasë vra ty pesë mijë shiptarë mes veti, pesë mijë gra të veja, pesë mijë fëmi, dhjetë-njizet mijë pa babë, pesë mijë n'burgje, pesë mijë n'varre. Kishte ni llogari katastrofale, na kish dalë shumë keq. Prandaj Lëvizja e bani këta që na me u qetësu n'shpiert, me u stabilizu, me u pajtu hasmëritë, edhe me qenë kompakt qe nesra... e dishim çka po na pret, qysh i ndodhi Bosnjës, qysh i ndodhi Kroacisë, qysh i ndodhi Sllovenisë, edhe na ndodhi edhe neve.

Edhe këtu ishte aja bërthama, aja iniciativa, edhe mjerisht që hala s'janë ba analiza si duhet, edhe me iu dhanë haku kësaj Lëvizje. Une do t'iu falenderoj juve për iniciativën, për angazhimin me i qitë n'sipërfaqe këto sene, se këto çka i une fola është miniaturë, është shumë pak. Kanë me folë edhe shoktë e mi, po prap pak. A kjo punë donë qasje studimore, donë angazhim, donë gjeneratat e reja me... se ka materiale, ka dëshmi t'gjalla. Na edhe pak kohë do ta harrojmë edhe luftën nëse nuk shkruhen senet. As t'luftës s'po shkruhen senet sa duhet. Po shkruhen për dëshmorët qe janë vra. Une kam propozu, pse n'Bubavecin tim shteti mos me çu formularë, në çdo familje, "Shkrujë çka t'ka ndodhë ty këto vite t'luftës, ku je kanë, çka t'ka hupë, kah je kanë, çka u bo me ty?" Nuk është e thane me u publiku, me i botu, me ba libër; lidhi me ni sixhim, futi ni thes, biri n'arkiv t'Kosovës. Mas ni qind vjete djali jem donë me e ditë, stërnipi i jem, ku ka qenë, çka ka ba familja e jem, shkon e gjanë n'arkiv: familja e Mulla Xhevat Kryeziut u janë kjo, kjo, kjo, çka ka bo, tek ka bo.

Serbia pa kanë po i krijon këto mite, këto... i ban, i rritë. A na i kemi, e s'po i shkrujmë. Mjerisht! Po kanihere thom mos me e hupë krejt besimin, mos me ra krejt n'pesimizëm, thom, "Do t'vijjnë ditë t'mira." Del dikush si ju, se sikur ajo. Banë shënime, merr i qetë, vërtetohen, qiten n'sirtar, ruhen dikun, i sheh dikush, bahet diçka.

Erëmirë Krasniqi: Qysh e keni vazhdu aktivitetin e jujë kombëtar mas pajtimit t'gjaqeve? Edhe qysh është modifiku roli i jujë si imam?

Mulla Xhevat Kryeziu: Po tham, në vazhdimësi kam qenë pjesë e pandashme e këtyne akcioneve. Kam marr pjesë edhe n'luftë. Jam veteran i Ushtrisë Çlirimtare t'Kosovës. Kam qenë, kam punu në shoqatën bamirëse "Nëna Terezë". Kam qenë nënkryetar n'Malishevë. Qe ka qenë absurd, "Qysh Mulla Xhevati me Nënë Terezën?" Po une e kam pa çashtjen e kombit. Se kam kqyrë çashtjen te feja. S'më ka pengu Nënë Tereza. Po na i kena çu mija, e mija, e mija tonelata bukë u kemi dhanë popullit. Autonomia e suprimume, njerzhtë t'përzamë nga puna, mbyllen institucionet, e ka dhanë ni kontribut jashtëzakonisht "Nanë Tereza", shoqata "Nanë Tereza". Edhe n'Malishevë, edhe n'krejt Kosovën. Kom punu n'këshill për financim, me i majtë arsimtartë gjallë, me i financu, me ia dhanë ka ni qind marka, me majtë arsimin gjallë. Kom punu me i sistemu nxansat prej shkollës n'shpi, me i ba shtëpiat shkolla. Kom punu "Miqtë e TMK-së", edhe aty kom punu, me iu nimu, se shtresat e masluftës kemi dalë, kemi lypë ndihma me iu çu, se s'kanë pasë ekzistencë. Ishum... sa dolëm pi luftës. Domethanë, qe kam qenë pjesë e angazhimeve ku ka pasë nevojë për popullin tim.

Erëmirë Krasniqi: Qysh e keni kalu luftën?

Mulla Xhevat Kryeziu: Luftën e kena kalu midis malit. Ka ardhë ofanziva, ne kemi qenë për fat t'keq afër Kievës. Simas Hollbrukut, strategut, edhe mikut tonë t'madh Hollbrukut, Kieva ishte pika ma e ndieshme e munsisë t'shpërthimit t'ni luftime t'tmerrshme, qe ndodhi. Dhe aty thuajse gati se u banë projektet, u banë planet. Kur u dashtë Kieva m'u çliru, erdhën nga katër anë, sulmunë Kievën. Edhe u hapë lufta. Domethanë, me Kievën është hapë lufta. Se u mbetën aty do serbë t'nxanë, edhe met ni shka aty, qe p'ia harroj emrin atina qysh e patë.

Dhe e zuni lufta, u blloku Ushtria Çlirimtare, i qiti pengesat, i zuni istikamet, ma nuk linte me lëvizë ma. Ata ishin pak me ia mësy ushtrisë. Ushtria ishte e fuqishme, edhe met e izolome.

Erëmirë Krasniqi: A '97, a '98, a?

Mulla Xhevat Kryeziu: Kjo? Jo kjo ishte '98-ta. '98, se n'98 filloi lufta. Dhe na, une nuk e harroj kur u themelunë shtabet. U themelu edhe n'Bubavec edhe isha në logjistikë. Mu m'kanë pasë me iu sjellë t'mira materiale. Une kom hi mrena: a lopën, a mshtjerrën, a bullicë, a kingjin, a dashin, a pulën, a orizin, a millin, mu s'ma kanë nalë. Edhe i kom majtë tamon... e ka pasë stilin e ni hoteli shtabi jonë aty. Qashtu e patëm ni vend, edhe kanë pasë kushte t'mira. Me 28 korrik, asht' sulmu Kieva, edhe na e kemi lëshu Bubavecin, kemi dalë n'male. Edhe kemi nejtë tre mujë ditë.

Me 28 nandor, na kanë kthy verifikustë. Janë ardhë, u ba ni marrëveshje me Millosheviqin. Ish dimën, 28 nandori. Me t'28-tin jena ardhë n'shpiat tona t'djegta, t'kallta, qashtu kena ekzist. Kanë ndërhy shoqatat humanitare. Ka qenë "Karitasi" zviceran, "Kapenhajmuri" gjerman, edhe disa shoqata tjera. Edhe fillunë me ia qitë çatitë, fillunë me i ly kapak. Na prunë do farë sungjera me fjetë, na prunë batanije me fjetë. Edhe na fillumë me kalu ni dimën t'mirë. Dhe ishëm n'mal domethanë, tre mujë ditë. Dhe pastaj jemi kthy me t'28-tin. Me 24 mars, kur ka bombardu Serbia... kur e ka bombardu Serbinë NATO-ja, se u murr vendimi i NATO-s, kanë fillu bombardimet e NATOS-s, ne prapë jemi detyru me i lëshu shtëpijat. Edhe prapë jemi detyru me shku nëpër malet tona. Edhe aty deri me 14 qershor kemi qenë nëpër male.

Erëmirë Krasniqi: Qysh mbijetojshit?

Mulla Xhevat Kryeziu: Kemi mbijetu... njeriu ishte ma i fortë se guri. S'di qysh jeton ni njeri n'mal, domethanë njeri po bajke egërsirë me jetu n'mal. Egërsirë po u bajke. Kur m'ka rastisë puna me ni kohë me shku në ni fshat... e djegën edhe masi qe e djegën se banë shpuzë e hi qe thojmë na, u largunë forcat serbe, popullata u kthy n'ato vene t'djegta. Po ishin nëpër oborre t'veta. Dikush pa çati, dikush me çati, dikush pak e dikush shumë, po ishin nëpër oborre. Edhe kom shku te njeni edhe kur jam futë mrena, jam futë... ishte shpia, nuk iu kishte djegë për fat. Edhe une sa kohë rrishna, rrishna tu i kqyrë muret. Isha mësu n'mal, tre mujë n'mal, pa pa kulëm.

Edhe na prunë bukën, prunë sofrën. M'kish marr malli me pa sofër. Mas asaj, ka ardhë ni tepsi, qe i thojmë na përpeq, pite me gjizë, dhe ni pjatë me kos. Ishëm na dy qe ishëm aty edhe familjari tre. Pi thom une, "A mujna m'u ngi na bukë këtu? Mos i lamë fëmitë pa bukë?" "Jo, nginu lirisht. N'mufshi krejt me hangër." Me u ngi bukë, ishte punë e madhe, domethanë ishëm midis malit. Sa ishte vranët, na ishëm nervoz. Se kur ishte kthjellë, vishin aeroplantë bombardusë t'NATO-s, bombardojshin çaçet. Kur ishte vranët, ata s'vishin, nuk i shihshin pozicionet. E na t'strukun se Serbia tash sulmojke, gjujke Serbia. A qetash po vritmi, a qetash, a qetash, a qetash.

Erëmirë Krasniqi: A kishit forca t'UÇK-së me veti?

Mulla Xhevat Kryeziu: Po na kishim forca të UÇK-së, po ato forca ishin t'pakta me i përballu 50 tanke. Ishum rreth e rreth n'tanke. Ni mujë ditë ka shti Serbia tanke n'Kosovë, ni mujë ditë po u nalë, kolonat pa u nalë qe i kemi përcjellë. Ishte ajo marrëveshja hala pa u përfundu, marrëveshja ishte. Edhe ishte situatë e ranë. Edhe ne ishëm n'mëshirën e zotit, n'mal. Qashtu tu e majtë njeni tjetrin. Deklaratat e Klintonit se vera do t'jetë stina ma e mirë, verës do t'iu nimojmë, verës do t'bahet mirë, thojshim na, "Po dej verës a mujna me qëndru na? A mujna me pritë na verën këtu?" Fshatrat ishin plot paramilitarë serbë, aty-këtu naj lagje qe ishin larg n'periferi t'naj fshatit. Aty me shku, shkojshin UÇK-ja.

Mu m'lanë furnizusë t'nja dymdhetë mijë banorëve. Tani une e bajsha ni regjistër, e shkojshin ushtria, u organizojshin, i marrshin njerz të me veti. Po nja dhetë kilometra, me i marrë thastë me veti e me i gjetë rezervat qe i kishin lanë njerz të tanë nëpër shpia, po kanë ikë. Iu ka metë milli atje. Me shku ma marr ata millë, edhe ka 20 kilogramë, 15-30 kilogramë edhe me ia dhanë, edhe me i majtë gjallë për mos me e lanë me ra n'durë... Kishte tendencë dikush, "Du me shku une me u dorëzu te serbtë." "Po a je more n'men? Ata t'pjekin." "Epo çka me ba? Don me m'dekë fëmija." Mule na me dalë tani me iu gjetë millë, me iu gjetë vaj e sene tjera.

Pastaj kemi qenë, aty na kemi pasë ni fshat, thirrej Bubël. Ai fshat fatmirësisht nuk u djeg. Kalunë asajde, nuk u nalën forcat aty edhe pshtoj. Dhe aty, ai fshat ishte i fortë ekonomikisht edhe kishte hambarë plot drithë, kishte edhe grurë, kishte edhe misër. E kur llogaritshim na qe ka misër edhe mujshim me e zi na atë misër, me hangër t'zimë, ishte ni satisfaksion, ni kënaqësi e kohës, e përkohshme. Kemi misër, hajmë misër, nuk desim uni. Mirëpo, dashti zoti qe me 14, kur i kom pa helikoptertë gjermanë qe janë ardhë nga Shqipëria në Prizren. Kanë ardhë kah na, i kom pa, janë lëshu n'Malishevë. Atëherë e kom ditë qe na fitumë edhe na shpëtumë. Edhe ishte kjo ni histori e tmerrshme.

Po, ishte krenare, se na pagujti zoti, na shpërblej zoti atë sakrificë, atë gjakderdhje, atë angazhim të gjithë këtij populli me liri, me pavarësi, me shtetin. Na nimunë edhe faktori ndërkombëtar, edhe jemi këtu ku jemi tash.

Erëmirë Krasniqi: Qysh u kthytë te shpia?

Mulla Xhevat Kryeziu: U kthymë te shpia... he! Dy ditë para se mu kthy na me familje, depërtova une edhe erdha te shpia. Edhe shpia ishte djegë. Edhe Serbia tu u tërheqë me forca nga... gjithçka që ishte e djegtë. E pava ni lopë kishte metë gjallë. Ish kanë e plagume pi plumave. Edhe u ktheva. Nana, ndjesë pastë, po m'pret, "O Xhevat," "Oj nanë," "A ktheve n'shpi?" "Kesh n'shpi." "Çka kish bre nanë t're?" "Nanë, zoti na dhashtë bereqet, shpijat janë t'djegne." "Oj nanë, e dritaret e kishin shpëtu?" Thashë, "Po, oj nanë, dritaret ishin n'ven. Po, oj nanë, çfarë dritare! U djegë krejt shpia, po çfarë dritare, oj nanë." Kish qejf ajo e shkreta, "Oj nanë, dritaret a janë shpëtu?" Po u djegë krejt shpia, dritaret a janë metë? "Oj nanë, po jo oj nanë. Po kofshum na, se i bajmë".

Ishte kjo ajo malli. Na edhe thojshim, "Veç le t'hjeken kta, e t'kthehemi n'oborr. Me ato tenda t'najllanit do t'jetojmë." "Dhe leje qe do t'jetojmë, po do t'kalojmë mirë njani me tjetrin." Qe nuk ndodhi kjo kështu. Sa u kthymë na, erdhëm nëpër shpia tona, filloi tash lakmia mu pasunu, mu ndërto. Filloi kacafytja, fillunë telashet, fillunë hallet. E nuk ishëm ata qe kem n'mal, "Qysh je bre vëlla? A shpëtove

bre vëlla? A shpëtove bre motër? Si kalove bre motër? Hajde ta jap ka pak millë, hajde ta jep ka pak bukë.” Me i nimu njani tjetrit, domethanë ishte ajo dashuria pak artificiale. Nuk ishte ajo krejt qe thojmë na *fise-bile-al* për zotin. Edhe po na kallxon tash praktika. Tash ju p’e shihni çka po bahet, qe ne nuk na ka hije me qenë kështu. S’na ka hije me ba kështu. Ne na ka hije ni politikë unifikuse, qe na bashkon, na afron.

Mujmë me pasë kundështime programet e partisë, po tana shqiptare, po, jo me ardhë me mytë njani tjetrin, jo me mytë policin. Po, une thom ishalla edhe kjo kalon. Edhe këto ishin ato momente, ishin t’rana. Sa i kena përjetu na nëpër male, deshë, dathë.

Erëmirë Krasniqi: Çka ndodhi me xhaminë e jujë?

Mulla Xhevat Kryeziu: Me xhaminë tem? Me 24 gusht e kanë kallë xhaminë teme. Na dulë me 22... me 28 korrik, me 24 e kanë djegë xhaminë e Bubavecit. Pi xhamiave t’para qe o djegë. Se n’atë xhami përveç se u majtë pajtimi i gjaqeve, ata e kena pasë teatër, e kena pasë shkollë, e kena pasë për konferenca, për tubime. E pata shndërru në shërbim të çashtjes kombëtare. Vetëm xhumaja dhe vaktet ishin në shërbim t’fesë, tjerat krejt ishin në shërbim t’kombit, me t’gjitha tubimet. Aty janë majtë programe, aty janë majtë koncerte, aty janë majtë teatër, aty o mbajtë drama, aty o mbajtë gjithçka.

Dhe isha kah ora 15 n’dhetë. Ni rreze e dillit, e kisha marrë do bukë isha tu e hangër. Po m’thotë njani, “Xhevat ku je? “Qe qitu.” “Paja ka.” “Ha?” “Hajde me pa, xhamia po na djeget.” “Ma bre!” E jam dalë, jam hypë në ni muri, “Xhamia po kallet,” une po kajë. “Xhamia po djeget,” unë po kajë. Edhe e kom përcjellë derisa iu ka shafitë kulmi krejt. Ka pasë materiale, ka pasë dokumente, ka sene. Aty asht’ domethanë, pi xhamiave t’para qe o djegë, asht’ xhamia e Bubavecit. E kanë pasë shënjestër, ato edhe mu. Po dashti zoti, e bamë na xhaminë. Xhamia u ba, u ba edhe ma mirë.

Edhe në 20 vjetorin e pajtimit t’gjaqeve, Këshilli i Lëvizjes vendosi qe me emëru xhaminë e Bubavecit, Xhamia e Pajtimit. Edhe sot e ka pllakën, “Në këtë xhami me 26 prill, viti 1990, u bo pajtimi i gjaqeve t’Kosovës- Lëvizja Kombëtare për Pajtimit e Gjaqeve”. Edhe ajo quhet Xhamia e Pajtimit. Xhamia e vetme n’Kosovë qe thirret Xhamia e Pajtimit.

Erëmirë Krasniqi: Çfarë karakteri tash kishin këto xhumatë e juja mas luftës? Po mendoj, a i jepshit ma shumë fjalë inkurajuse njerëzve, a qysh?

Mulla Xhevat Kryeziu: Po gjithmonë. Gjithmonë bisedat i kena zhvillu në interes t’popullit, n’forcimin, n’mobilizimin e shpirtrave t’tyne, qe ata njerëz me i përballu, me i tejkalu këto vështirësi, këto pengesa qe i kem. Se vetëm bashkë, vetëm bashkarisht, vetëm tu e përkrah njani-tjetrin, vetëm tu e nimu ia dalim n’skejt. Edhe gjithmonë kanë qenë ligjëratat t’qasaj fryme. Po jo vetëm t’miat, po edhe t’shokëve t’mi, kolegëve t’mi, domethanë t’spektrit. Po jo vetëm të besimit islam, po sigurisht se kanë qenë edhe ato të besimit katolik, nëpër kisha ligjëratat qe janë majtë, iu kanë kushtu çashtjes kombëtare, patjetër.

Erëmirë Krasniqi: A keni vërejtë naj krizë shpirtnore mas luftës te njerzit?

Mulla Xhevat Kryeziu: Njeri shpesh herë bjen n’depression kur sheh ngjarje t’pakandëshme, kur nin situata t’dhimshme, qe nuk kemi meritu me na ndodh do sene neve. Une kam mendu, nëse gjermani i banë dhetë orë gjumë, na duhet m’i bo dy orë, ose ni orë. Gjermantë kanë sakrifiku pas çlirimit, kanë vujtë, kanë qenë edhe ma ran’ se na ata. Po, tu e përkrah njani-tjetrin, tu iu kushtu çashtjes kombëtare edhe i kanë konsolidu rradhët e veta, forcat. Janë bashku, edhe kanë dalë prej situatës.

Prandej edhe na është mirë me e marr ni mësim t’tillë. Është mirë m’u angazhu shumë deri t’a bajmë shtetin si duhet. T’a bajmë ni shtet ligjor, t’a kem t’drejtën tonë, t’a kem mendimin e lirë të shprehjes. Vota e popullit e përcakton perspektivën e njerëzve. Ani, po jo me dhunë, e jo me force. Sene qe s’na takojnë këto senet qe p’i shohim, dukuritë negative. Edhe jo rastësisht jemi këtu ku jemi. Mbetëm ma t’mbramtë, t’izolumë. Krejt bota lëvizë lirshëm, na hala s’kem t’drejtë, me shku... vetëm n’Shpini edhe n’Maqedoni, edhe n’Mal t’Zi.

Erëmirë Krasniqi: A keni pajtu gjaqe mas luftës?

Mulla Xhevat Kryeziu: I kena pajtu mas luftës dikun, e kam statistikën, mos gabofsha dikun 58 gjaqe i kom t’kryme pas luftës. E ngatërresat janë me qindra ato. Janë ndoshta edhe me mija. Tash po du me ba... se librin e kemi botu mas luftës meniherë, ni libër i vogël, ni monografi. E tash po du me e pergatitë, me i tubu materialet edhe ato pasluftës, edhe ato t’para luftës. Po ato t’paraluftës fatkeqësisht qe m’u kanë djegë shumë, m’u kanë djegë dokumentet. Tash jam tu i tubu shënimet, me i kompketu edhe me pa saktë sa është numri i tyne. Edhe do t’a... dhashtë zoti, m’dhashtë ymër, s’dihet kjo punë, asht’ çashtje n’pikëpytje kur, se jemi tu jetu me sen t’hujë. Po nëse asht’ ymri, shëndeti, une do ta botoj ni monografi, shënime, ata qe e kemi ba, edhe me e lanë qaty. Le ta kenë kujtim gjeneratat qe vijnë. Me pa çka asht’ ba.

Erëmirë Krasniqi: Kujna ia falin gjakun këta njerzë?

Mulla Xhevat Kryeziu: Gjakun njerzë gjithmonë e kanë mbështetë n’emën t’krijusit, n’emën t’zotit, dhe në emën t’gjakut të dëshmorëve, pas luftës. A para luftës u falë n’emëm t’zotit, n’emën t’bashkimit, n’emën t’popullit, n’emën t’familjes, n’emën t’atyne qe janë n’varre, pleqëve t’tyne për nder. Po tash falet n’emën të zotit gjithsesi, edhe n’emën të vlerave të luftës, n’emën të dëshmorëve qe ni armatë e madhe janë... dikun rreth 15 mijë vetë qe janë vra, disa qe s’dihet hala ku i kanë varret e tyne, edhe qyshtu.

Erëmirë Krasniqi: Qysh organizohen sot pajtimet?

Mulla Xhevat Kryeziu: Po lajmërohen rastet, lajmërohen njerzë. Tashma veç p’e dinë njerzë qe janë marr edhe qe merren me këtë veprimtari. Ma jem tash me adresa t’caktume. Nuk asht’ problem me na gjetë nëpërmes mediave, nëpërmes televizionit, nëpërmes intervistave. Njerzë p’e dinë ma qe jem na ata argatë, edhe s’jemi lodhë. Edhe vijnë e tregojnë hallin e vet, e tregojnë dertin qe kanë, problematikën qe kanë, edhe na i qasemi kësaj pune gradualisht, kadal dale. Kemi pak ma problem, kemi pak ma ranë, se nuk asht’ ma ajo gatishmëria qe ishte para luftës. S’është ma ajo gatishmëri. Kemi pak ma problem, megjithëse edhe rastet janë ma t’reja, tash janë ma t’freskëta. Po sidoqoftë, po

korrmi sukses, ka sukses, ka rezultat. Edhe ai rezultat na banë qe ne me vazhdu deri n'momentin qe dorzohemi para zotit, qe dalim prej kësaj jete, s'do të ndalemi, une me shumë shokë.

Erëmirë Krasniqi: A ka raste t'vjetra edhe para luftës?

Mulla Xhevat Kryeziu: Ka, po janë pak. Janë ato raste, për shembull në komunën tonë janë ni rast, m'doket dy raste, qe s'kena mujtë m'i pajtu. T'gjitha tjerat... n'komunat tjera... asht' pak ma specifike, pak ma situatë e veçantë asht' në rrethinën e Gjakovës. Ka ma shumë gjaqe t'vjetra, sidomos të besimit krishterë. Që s'kemi mujtë me profesor Antonin me ndiku. Ishalla donë zoti na nimon e bohët edhe aty mirë, gjithkrah. Po megjithate, po thom, jemi t'angazhumë edhe jemi t'përkushtumë. Deri në momentet e dorëzimit nga kjo jetë do t'punojmë në të mirën e popullit tim e vendit tim, pa u ndalë.

Jeta Rexha: Faleminderit shumë. Që keni me shtu diçka, që mendoni qe kena harru?

Mulla Xhevat Kryeziu: Unë iu falenderoj ju për këtë angazhim t'jujin, se kjo është ni punë e mirë qe bahet. Tubohen materiale arkivore, shënohen, jesin n'kujtesë, vijnë gjeneratat tjera, edhe pse jeni ju t'ri. Po ju sigurisht keni m'u plakë, ishalla plakeni, e gëzoni jetën. Edhe ju kqyrni çka keni bo ju, edhe iu kujtohet çka kemi bo na. Edhe ishalla nuk na bjen me u përsëritë gjakderdhje n'Kosovë. Na krejt këta e kena bo me parandalu vëllavrasjen, me parandalu gjakmarrjen, me parandalu t'keqen. Kjo ishte aja esenca, kjo ishte thelbi i asaj. Edhe uroj t'mos ketë raste, ishalla s'ka me pasë. Po mjerisht qe prapë po ka, edhe do t'vazhdon e keqja n'mesin tonë derisa hala do t'shkollohemi, derisa t'a kuptojmë jetën, t'a kuptojmë t'vërtetën, t'a kuptojmë kombin. Edhe kemi hala pengesa, kena hala telashe.

Erëmirë Krasniqi: Deshta veç edhe ni pyetje, qysh e organizoni sot aktivitetin e pajtimit?

Mulla Xhevat Kryeziu: Une thashë edhe niherë: ne prapë po e vazhdojmë me t'njejtin ritëm, me t'njejtin angazhim, vetëm se n'masë ma t'vogël. Nuk jem ma ato ekipet ka dhetë e, 20 e, 30, po pesë, e gjashtë, e shtatë, e tetë, e dhetë. Tubohemi edhe shkojmë nëpër familje, akoma edhe sot. Domethanë e kem qat' stil t'punës, qat' angazhim t'punës, vetëm qe i përmasave ma t'vogla. S'është akcion ma gjithëkombëtar, po aty ku ndodhë.

Erëmirë Krasniqi: Shumë faleminderit.

Mulla Xhevat Krasniqi: Faleminderit.